

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Shoqëria për eksport-import, tregti me shumicë dhe pakicë të tekstilit dhe konfeksioneve FASHION COMPANY Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Beograd me seli në bulevardin Mihajla Pupina 115b, 11070 Beograd, Republika e Serbisë, përmes Shoqërisë së Avokatëve Polenak nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 30.01.2025, solli këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Shoqëria për eksport-import, tregti me shumicë dhe pakicë të tekstilit dhe konfeksioneve FASHION COMPANY Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Beograd, me seli në bulevardin Mihajla Pupina 115b, 11070 Beograd, Republika e Serbisë, synon të fitojë kontroll të pavarur drejtpërdrejt mbi AB-Line d.o.o. Sarajevë, me seli në Haliloviqi 6, 71000 Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, përmes blerjes së pjesës, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose prishjen e konsiderueshme të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptimin e nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Sipas dispozitave të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Ligji), më 30.12.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga Shoqëria për eksport-import, tregti me shumicë dhe pakicë të tekstilit dhe konfeksioneve FASHION COMPANY Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Beograd, me seli në bulevardin Mihajla Pupina 115b, 11070 Beograd, Republika e Serbisë (në vijim: FASHION COMPANY), me të cilin FASHION COMPANY do të fitojë kontroll mbi AB-Line d.o.o. Sarajevë, me seli në Haliloviqi 6, 71000 Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë përmes blerjes së pjesës.

Komisioni e filloi shqyrtimin e Njoftimit ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe bashkëngjitjeve të tij konstatoi si më poshtë:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

FASHION COMPANY ka të regjistruar aktivitetin – tregti me shumicë të pa specializuar.

Në Maqedoninë e Veriut, FASHION COMPANY ka një shoqëri të varur të regjistruar – Shoqëria për tregti me shumicë dhe pakicë të tekstilit dhe produkteve tekstile EUROFASHION TRADE SHPK import-eksport Shkup, me seli të regjistruar në rr. Nikola Kljusev nr. 6, kati 7, Shkup dhe me aktivitet të regjistruar – tregti me pakicë të rrobave në dyqane të specializuara.

AB-Line d.o.o. Sarajevë është shoqëri që merret me import dhe shpërndarje të veshjeve, këpucëve dhe aksesorëve të ngjashëm të modës, përmes rrjetit të vet me pakicë dhe shumicë.

AB-Line d.o.o. Sarajevë nuk ka shoqëri të lidhura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut, nuk është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka realizuar të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ

